



Rrjedha e epidemisë COVID-19 në Kosovë!









Komunikatë për media

19/03/2020

Komunikatë për media

ASNJË RAST I KONFIRMUAR ME COVID-19!

Sot me 19.03.2020 në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKSHPK me metodën RT-PCR, janë testuar 16 mostra të dyshimta për virusin SARS-CoV-2 dhe të gjitha janë negative.

Nga data 08.02.2020 deri me 19.03.2020, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKSHPK me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 335 mostra të dyshimta në virusin SARS-CoV-2 dhe prej tyre, gjithsej njëzet raste kanë rezultuar pozitive.

Në qendrën e thirrjeve deri më tash janë pranuar në total 2.597 thirrje, ndërsa vetëm në 24 orët e fundit janë pranuar 553 thirrje telefonike.

Nga data 01.02.2020 deri me 19.03.2020 në Aeroportin ndërkombëtar “Adem Jashari” si dhe në pikat tokësore kufitare janë depistuar gjithsej 14.442 udhëtarë. Në Aeroportin “Adem Jashari” 1.015 udhëtarë, Merdare 4.882, Vërmicë 3.832, Jarinje 929, Dheu i Bardhë 891, Hani i Elezit 1.430, Kullë 822, Qafë Morinë 47, Bërnjak 414, Qafë

Prush 35, Muçibabë
144 dhe Gllboçicë 1 udhëtarë.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
të Kosovës (IKSHPK) po përcjell me vigjilencë të shtuar situatën
epidemiologjike me COVID-19, po monitoron të gjitha rastet e kontakteve
dhe atyre të cilëve u është rekomanduar për vetëizolim shtëpiak.

Ekipet e QRShP në rajonet përkatëse
janë në terren dhe janë duke i kontakuar kontaktet e kontakteve të rasteve
pozitive me COVID-19 për mbikëqyrje të
rreptë për 14 ditë duke rekomanduar që personat të vetëizolohen dhe ata që kanë
simptome të lajmërohen në klinikën infektive.

Në IKShPK në vazhdimësi përgjatë 24 orëve janë duke u kontaktuar dhe
mbikëqyrë të gjitha kontaktet e rasteve, si dhe kontaktet e kontakteve duke iu
obliguar për vetëizolim dhe të kërkojnë ndihmë mjekësore nëse kanë simptome.

Në bazë të qarkores së Ministrisë
së Shëndetësisë është rekomanduar reduktimi i operacioneve elektive dhe i
vizitave në ambulancat specialistike spitalore.

Në nivel global, nga data 31 dhjetor 2019 deri më 19 mars

2020 sipas Worldometers, janë raportuar gjithsej 225.252 raste të COVID-19 me 9.276 raste të vdekjes, numri më i madh i rasteve raportohet nga Kina (80.928), Italia (35.713), Irani (18.407), përderisa në BE/AEE dhe Mbretëri të bashkuar janë raportuar gjithsej 93,419 raste të COVID-19: Itali (35.713), Spanjë (14.769), Francë (9.134), Gjermani (12.327), Mbretëri të Bashkuar (2.626), Holandë (2.051), Belgjikë (1.486), Greqi (418), Turqi (191), Serbi (97), Kroaci (99), Shqipëri (59), Maqedoni e veriut (43) dhe Mal të zi (8).

Deri me 19 mars 2020, numrin më të madh të vdekjeve e shenon Kina me (3.245), Italia me (2.978), Iran (1.284), nga vendet e BE/AEE dhe Mbretëri të Bashkuar janë raportuar 4.188 raste të vdekjes: Itali (2.978), Spanjë (638), Francë (264), Mbretëri të Bashkuar (104), Gjermani (31), Belgjikë (14), Norvegji (6), Austri (5), Poloni (5), Greqi (5), Luksemburg (4), Danimarkë (4), Bullgari (3), Irlandë (2), Turqi (2), Shqipëri (2), dhe Hungari (1).

Në këtë situatë vetëdija dhe ndihma e juaj është e domosdoshme. Mbani distancë nga tjetri. Reduktoni daljet veç në raste emergjente. Ndiqni rekomandimet nga Ministria e shëndetësisë dhe Instituti kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Ju faleminderit për mirëkuptim!

IKSHPK: GJASHTËMBËDHJETË RASTE TË KONFIRMUARA ME KORONAVIRUS!

Komunikatë për media

Nga data 08.02.2020 deri me 17.03.2020, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKSHPK me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 271 mostra të dyshimta në virusin SARS-CoV-2 dhe gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) prej tyre kanë rezultuar pozitive.

Gjatë orëve të mesnatës me 17.03.2020 është konfirmuar edhe një rast pozitiv për virusin SARS-CoV-2: E ardhur nga Londra me datë 16.03.2020, ku ka qëndruar në vizitë zyrtare nga data 09-16.03.2020. Rasti me vendqëndrim nga Prishtina, gjinisë femër, mosha 39vjeç.

Nga data 13.03.2020 kur janë konfirmuar dy rastet e para, deri sot me 17.03.2020 gjithsej gjashtëmbëdhjetë raste pozitive të konfirmuara për virusin SARS-CoV-2: Rastet janë 7 raste nga fshati Stubëll e epërme – Vitisë, 4 raste nga komuna e Malishevës dhe me nga një rast komuna e Klinës, Prizrenit, Podujevës, Obiliqit dhe Prishtinës. Shtatë prej tyre raste të importuara tashmë nga vendet që raportojnë për qarkullim të COVID -19. Tetë prej tyre të gjinisë femërore dhe tetë mashkullore, rastet janë të grup-moshave 5 – 14 (2 raste), 15-24 (2 raste), 25 – 34 (3 raste), 35 – 44 (4 raste), 45 – 54

(2 raste), 55 – 64 (1 rast) dhe mbi 70 vjeç (2 raste).

Dhjetë prej tyre janë të hospitalizuar në Klinikën Infektive, gjendja e nëntë prej tyre është stabile përveç rastit të moshës 77 vjeçare i cili kohë pas kohe lehtësisht e rënduar dhe me Oksigjenoterapi.

Në qendrën e thirrjeve deri më tash janë pranuar në total 1901 thirrje, ndërsa vetëm në 24 orët e fundit janë pranuar 516 thirrje telefonike.

Nga data 01.02.2020 deri me 16.03.2020 në Aeroportin ndërkombëtar "Adem Jashari" si dhe në pikat tokësore kufitare janë depistuar gjithsej 10.653 udhëtarë. Në Aeroportin "Adem Jashari" 479 udhëtarë, Merdare 4.264, Vërmicë 2.989, Jarinje 742, Dheu i Bardhë 552, Hani i Elezit 734, Kullë 534, Qafë Morinë 41, Bërnjak 178, Qafë Prush 15, Muçibabë 124 dhe Gllobočicë 1 udhëtarë.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) po përcjell me vigjilencë të shtuar situatën epidemiologjike me COVID-19, po monitoron të gjitha rastet e kontakteve si dhe atyre të cilëve u është rekomanduar për vetëizolim shtëpiak.

Ekipet e QRShP në rajonet përkatëse janë në terren dhe janë duke i kontaktuar kontaktet e kontakteve të rasteve pozitive me COVID-19 për mbikëqyrje të rreptë për 14 ditë duke rekomanduar që personat të vetëizolohen dhe ata që kanë simptome të lajmërohen në klinikën infektive.

Në IKShPK në vazhdimësi përgjatë 24 orëve janë duke u

kontaktuar dhe mbikëqyrë të gjitha kontaktet e rasteve, si dhe kontaktet e kontakteve duke iu obliguar për vetëizolim dhe të kërkojnë ndihmë mjekësore nëse kanë simptome.

Në bazë të qarkores së Ministrisë së Shëndetësisë është rekomanduar reduktimi i operacioneve elektive dhe i vizitave në ambulancat specialistike spitalore.

Në këtë situatë vetëdija dhe ndihma e juaj është e domosdoshme. Mbani distancë nga tjetri. Reduktoni daljet veç në raste emergjente. Ndiqni rekomandimet nga Ministria e shëndetësisë dhe Instituti kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Ju faleminderit për mirëkuptim!

Siguria e vendit të punës në lidhje me COVID-19

Praktikoni higjienë të mirë:

- Ndaloni shtrëngimin e duarve – përdorni metoda tjera të përshëndetjes pa kontakte
- Pastroni duart në hyrje dhe vendosni posterë dhe materiale edukative informuese për larjen e rregullt të

duarve

- Mos prekni fytyrën, gojën, hundën dhe sytë
- Mbuloni gojën dhe hundën me gropëz të bërrylit ose me faculetë për një përdorim kur kolliteni dhe teshtini
- Dezinfektoni rregullisht sipërfaqet punuese si tavolinat, dollapat, dorëzat e dyerve
- Bëni ventilim të shpeshtë të hapësirave të punës duke hapur dritaret ose përmes kondicionerit
- Punëtorët të respektojnë distancën së paku 2 metra ndaj të tjerëve
- Punëtorët që punojnë në terren dhe e kanë të domosdoshëm ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve duhet poashtu patjetër të respektojnë distancën së paku 2 metra ndaj të tjerëve
- Shmangni sa më shumë punën me konsumatorë/klientë kur është e mundshme
- Informoni punonjësit, kontraktorët dhe klientët tuaj që nëse COVID-19 fillon të përhapet në komunitetin tuaj qoftë me simptome të kollës ose temperaturë 38.0 C e më tepër duhet të qëndrojnë në shtëpi. Ata gjithashtu duhet të qëndrojnë në shtëpi (ose të punojnë nga shtëpia) nëse u është dashur të marrin medikamente të thjeshta, siç janë paracetamoli/acetaminofeni, ibuprofeni ose aspirina, të cilat mund të maskojnë simptomat e infeksionit.

Kujdes në takime dhe udhëtime:

- Përdorni videokonferenca për takime, kur është e mundur
- Kur nuk është e mundur videokonferenca, zhvilloni takime në hapësira të hapura dhe të ajrosura mirë, me distancë

mes vete së paku 1 metër
- Konsideroni të riaranzhoni apo të shtyni takimet dhe mbledhjet e mëdha
- Vlerësoni rreziqet e udhëtimit të lidhura me punën

Kujdes për ushqimin

- Kufizoni ndarjen e ushqimit me të tjerët
- Fuqizoni kontrollet shëndetësore për stafin e kafiterisë/bufesë së organizatës/kompanisë dhe kontaktet e tyre të ngushta
- Siguroni që stafi i kafiterisë dhe kontaktet e tyre të ngushta të praktikojnë higjienë të rreptë

Qëndroni
në shtëpi nëse…

- Jeni
  të sëmurë dhe keni një anëtar të sëmurë të familjes në shtëpi

---

Komunikatë për media

EDHE DY RASTE TË
REJA TË KONFIRMUARA ME KORONAVIRUS!

Nga data 08.02.2020 deri me 16.03.2020, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKSHPK me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 263
mostra të dyshimta në virusin SARS-CoV-2 dhe gjithsej pesëmbëdhjetë prej tyre
kanë rezultuar pozitive.

Krahas trembëdhjetë rasteve pozitive të
deritashme, sot me 16.03.2020 në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në
IKSHPK me RT PCR janë konfirmuar edhe dy
raste të reja pozitive për virusin SARS-CoV-2: Dy rastet janë dy të fejuar të ardhur nga Londra sot me datë 16.03.2020 me fluturim direkt Londër -Prishtinë. Të dytë kanë qëndruar në Londër nga data 04
mars deri me datën 16.03.2020, dhe sot janë detektuar nga shërbimet
shëndetësore të aeroportit ndërkombëtar “Adem Jashari” dhe të përcjellur me
auto ambulancë për në Klinikën Infektive-SHSKUK. Rastet janë me vendqëndrim nga
fshati Korishë-Prizren dhe tjetri nga komuna e Obiliqit. Njeri i gjinisë
mashkull dhe tjetri rast i gjinisë femër, të dytë të moshës 26 vjeçare.

Në qendrën e thirrjeve deri më tash janë

pranuar në total 1600 thirrje, ndërsa vetëm sot nga orët e hershme të mëngjesit
janë pranuar 215 thirrje telefonike.

Nga data 01.02.2020 deri me 16.03.2020 në
Aeroportin ndërkombëtar “Adem Jashari” si dhe në pikat tokësore kufitare janë
depistuar gjithsej 10.653 udhëtarë. Në Aeroportin “Adem Jashari” 479 udhëtarë,
Merdare 4.264, Vërmicë 2.989, Jarinje 742, Dheu i Bardhë 552, Hani i Elezit
734, Kullë 534, Qafë Morinë 41, Bërnjak 178, Qafë Prush 15, Muçibabë 124 dhe Gllobočicë
1 udhëtarë.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
të Kosovës (IKSHPK) po përcjell me vigjilencë të shtuar situatën
epidemiologjike me COVID-19, po monitoron të gjitha rastet e kontakteve si
dhe atyre të cilëve u është rekomanduar për vetëizolim shtëpiak.

Ekipet e QRShP në
rajonet përkatëse janë në terren dhe janë duke i kontakuar kontaktet e
kontakteve të rasteve pozitive me COVID-19
për mbikëqyrje të rreptë për 14 ditë duke rekomanduar që personat të
vetëizolohen dhe ata që kanë simptome të lajmërohen në klinikën infektive.

Në IKShPK në

vazhdimësi përgjatë 24 orëve janë duke u kontaktuar dhe mbikëqyrë të gjitha
kontaktet e rasteve, si dhe kontaktet e kontakteve duke iu obliguar për
vetëizolim dhe të kërkojnë ndihmë mjekësore nëse kanë simptome.

Në bazë të
qarkores së Ministrisë së Shëndetësisë është rekomanduar reduktimi i
operacioneve elektive dhe i vizitave në ambulancat specialistike spitalore.

Në nivel global, nga data 31 dhjetor 2019
deri më 16 mars 2020 sipas ECDC, janë raportuar gjithsej 167.414 raste të
COVID-19 me 6.507 raste të vdekjes, përderisa në BE/AEE dhe Mbretëri të
bashkuar janë raportuar gjithsej 51.771 raste të COVID-19 me 2.316 raste të
vdekjes: Itali (1.811), Spanjë (288), Francë (127), Mbretëri të Bashkuar (35), Gjermani
(12), Belgjikë (4), Greqi (4), (3),
Poloni (3), Bullgari (2), Irlandë (2), Austri (1), Danimarkë (1), Hungari (1),
Luksemburg (1), Norvegji (1) dhe Shqipëri (1).

Në rast të ndryshimit apo përkeqësimit të
situatës epidemiologjike me COVID-19 në Kosovë, rekomandimet mund të pësojnë
ndryshime. Qytetarët do të jenë të informuar në kohë reale për çdo ndryshim
eventual të tillë

Në këtë situatë vetëdija dhe ndihma e juaj
është e domosdoshme. Mbani distancë nga tjetri. Reduktoni daljet veç në raste
emergjente. Ndiqni rekomandimet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti
Kombëtar i Shëndetit Publik.

Ju faleminderit për mirëkuptim!

Italia i dhuron pajisje mbrojtese personale Institutit Kombëtar

13 mars, 2020

Në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike, është
mbajtur ceremonia e dhurimit të pajisjeve personale mbrojtëse, për personelin
shëndetësor, në departamentin e Mikrobiologjisë, për të parandaluar
koronavirusin.

Drejtori ekzekutiv i Institutit Kombëtar, Prof. Dr.
Naser Ramadani, u shpreh mirënjohës ndaj ambasadorit italian, z.Nicola Orlando,
duke thënë se ky është një donacion me rëndësi shumë të madhe, në këtë kohë aq

të vështirë, që sipas tij, edhe pse momentalisht, nuk kemi asnjë rast të
konfirmuar në Kosovë, të jemi të mbrojtur nga ekspozimi ndaj kësaj sëmundje.

Ndërkaq, ambasadori i Italisë, z. Nicola Orlando tha
se situata në Itali është e vështirë, ndërsa theksoi se është e rëndësishme që
të izolojmë së pari veten, në mënyrë që të mbrojmë të tjerët.

Shefi i Departamentit të Mikrobiologjisë në IKSHPK,
Dr. Xhevat Jakupi e falenderoi ambasadorin Italian, dhe tha se në Departamentin
e Mikrobiologjisë tashmë po bëhet testimi për COVID-19.

Ai shtoi se këto pajisje personale mbrojtëse, janë dhuruar në momentin e qëlluar.

NË KOSOVË NUK KA KORONAVIRUS!

**Komunikatë për
media**

Nga data 08.02.2020 deri me 12.03.2020, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKSHPK me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 93
mostra të dyshimta në virusin SARS-CoV-2 dhe të gjitha kanë

rezultuar negative.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
të Kosovës (IKSHPK) gjatë ditës së sotme me 12 mars 2020, ka marrë informatë
nga Klinika Infektive e QKUK-së për njëmbëdhjetë raste të dyshimta në COVID-19.

Pacientët u kontrolluan nga ekipi i
infektologëve në Klinikën Infektive në QKUK dhe u morrën mostra për testim
laboratorik në virusin SARS-CoV-2.

Me datë 12.03.2020, në Laboratorin e
Mikrobiologjisë Molekulare në IKSHPK janë testuar njëmbëdhjetë pacientë në
virusin SARS-CoV-2 dhe kanë rezultuar negativ, domethënë pacientët nuk janë të
infektuar me virusin SARS-CoV-2.

Nga data 01.02.2020 deri me 12.03.2020 në Aeroportin
ndërkombëtar “Adem Jashari” si dhe në pikat tokësore kufitare janë depistuar gjithsej
5.045 udhëtarë. Në Aeroportin “Adem Jashari” 475 udhëtarë, Merdare 2.488, Vërmicë
1.456, Jarinje 374, Dheu i Bardhë 80, Hani i Elezit 77, Kullë 55, Qafë Morinë 30,
Bërnjak 7, Qafë Prush 2 dhe Glloboçicë 1
udhëtarë.

Me datë 12.03.2020, në aeroportin
ndërkombëtar “Adem Jashari” ekipet mjekësore të Aeroportit

bashkë me QKMF- Fushë
Kosovë dhe të mbështetur nga ekipi i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë
Publike të Kosovës kanë kontrolluar të gjithë udhëtarët sipas protokolleve të OBSH-së
dhe ECDC-së dhe te asnjeri nuk janë gjetur shenja klinike të sëmundjes.Të
gjithë udhëtarëve u janë dhënë materialet edukative informuese lidhur me
COVID-19.

Aktivitetet në lidhje me monitorimin, parandalimin e rrezikut të përhapjes së COVID-19

Duke pasur parasysh situatën
epidemiologiike me COVID-19 ditët e fundit, vlerësimin e rrezikshmërisë së OBSH (1 mars 2020) ME RISK SHUMË TË LARTË NË TËRË BOTËN, ECDC
(2 mars 2020) që e vlerëson si RISK I LARTË

dhe me (11 mars 2020) shpallje
e OBSH si pandemi, Komiteti për monitorimin e sëmundjeve ngjitëse
duke pasur parasysh situatën epidemiologjike në botë, Evropë
dhe në vendet fqinje, ka nxjerrë rekomandimet për Ministrinë e Shëndetësisë dhe të miratuara nga qeveria me datë 11 mars 2020, me qëllim të parandalimit të shfaqjes së rasteve të sëmundjes COVID-19
siç vijon:

1. Theksuar se situata
   epidemiologjike dinamike në vendet epidemike kërkon shqyrtim të rekomandimeve
   për shmangie eventuale të përhapjes së rasteve me linja

ajrore të udhëtimit ose
mjeteve tjera të komunikacionit.

2. Konstatuar se janë përforcuar masat
për monitorimin, parandalimin e rrezikut të përhapjes së COVID-19 që
konsistojnë në:

- Vazhdimin e zbatimit të parimeve themelore nacionale të reagimit në sistemin e mbikëqyrjes së rasteve.
- Depistimin dhe detektimin e rasteve të dyshimta, si dhe përcjelljen e dinamikës së sëmundjes;
- Konfirmimin laboratorik të rasteve të raportuara;
- Aktivizimin e ekipeve për hulumtim të epidemisë;

Ekipet e IKSHPK dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare janë dyfishuar dhe po përcjellin me vëmendje situatën epidemiologjike me Coronavirus në pikat hyrëse tokësore dhe aeroportin ndërkombëtar “Adem Jashari”.

3. Aktivitetet e rekomanduara nga Komiteti për monitorimin e sëmundjeve ngjitëse kanë vazhduar me masat për parandalimin e virusit në institucionet arsimore të Kosovës që konsistojnë në:

- Shpërndarjen e materialeve të edukimit dhe promovimit shëndetësor, posterëve dhe lifleteve.

- Organizimin e ligjëratave përkushtuar njohurive për Coronavirusin COVID- 19, të organizuara nga arsimtarët dhe profesorët me përkrahje të specialistëve të shëndetësisë publike të IKSHPK.

- Ndërmarrjen e hapave sipas rekomandimeve të IKSHPK që në të gjitha institucionet shkollore të bëhet dezinfektimi i shtuar i të gjitha sipërfaqeve dhe nyjeve sanitare.

4. Është ngritur shkëmbimi i informatave ndërinstitucionale mes Ministrisë së Shëndetësisë, IKSHPK, Qendrës së Situatave, Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave, SHSKUK, AUV, QKMF-ve, Policisë së Kosovës, FSK, MASHT.

5. IKSHPK, thekson se nuk ka vend për panik, por për kujdes të shtuar duke përsëritur rekomandimet:

- Shmangni kontaktet e ngushta me njerëzit që vuajnë nga infeksione akute të frymëmarrjes!
- Sa të jetë e mundur shmangni përshëndetjen me shtrëngim të duarve!
- Shmangni përqafimet dhe puthjet për aq kohë sa jeni në rrezik nga infeksionet respiratore!
- Lani shpesh duart, veçanërisht pas kontaktit të drejtpërdrejtë me njerëzit e sëmurë ose në vendqëndrimin e tyre!
- Lani duart porsa hyni në shtëpi!
- Lani duart para fillimit të përgatitjes së ushqimit!
- Lani duart pas përdorimit të tualetit!
- Lani duart sa më shpesh me ujë e sapun 20-30 sekonda, veçanërisht pas kontaktit të drejtpërdrejtë me njerëzit e sëmurë ose në vendqëndrimin e tyre!
- Evitoni përdorimin e tualeteve publike!
- Lani duart sa herë që teshtini apo kolliteni!
- Shmangni prekjen e fytyrës dhe mbuloni gojën dhe hundën me faculetë, me mëngë ose parakrahë gjatë kollës dhe teshtitjes. Pastaj hudhni faculetat e përdorura në shportën më të afërt të mbeturinave!
- Nëse keni ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje

kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore dhe tregoni historinë eventuale të udhëtimit jashtë vendit!

- Personat e sëmurë duhet të qëndrojnë në shtëpi në mënyrë që të parandalohet përhapja e sëmundjes!
- Mos frekuentoni ambientet mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz!
- Pini sa më shumë ujë, lëngje, çaj me limon!
- Të moshuarit dhe personat me sëmundje kronike nëse përdorin transportin publik të përdorin maska!
- Gjatë udhëtimit përdorni ushqime të paketuara!
- Personat të cilët kanë histori udhëtimi në zonat të cilat raportojnë për përhapje lokale të COVID-19 brenda 2 javëve të fundit, kanë kontakt të afërt me personat e konfirmuar ose të mundshëm me COVID-19, dhe kanë ethe, kollë ose vështirësi në frymëmarrje, duhet menjëherë të kërkojnë ndihmë mjekësore!
- Nëse personi nuk ka kontakt të afërt me të sëmurin por vetëm është kontakt potencial për atë se ka qëndruar në vendet ku ka raste me COVID-19, personit të tillë i rekomandohet izolimi vetë-shtëpiak edhe në prani të anëtarëve tjerë të familjes.

- Kontaktet
  këshillohen për monitorim të shëndetit për 14 ditë pas datës së fundit të
  ekspozimit dhe të kërkojnë kujdes të menjëhershëm shëndetësor nëse shfaqin
  ndonjë simptomë, veçanërisht ethe, temperaturë, simptoma të frymëmarrjes, siç
  janë kollitja ose vështirësi në frymëmarrje ose diarreja.
- Kontaktet
  duhet të konsiderojnë ushtrimin e vetë-izolimit për 14 ditë në shtëpi
- Është
  me rëndësi që ky person nuk duhet të shkojë në punë,

shkollë, kino dhe
ambientet publike ku ka grumbullim të
shumë personave

Rregulla e parë e izolimit në shtëpi është:

- Personat
  e moshuar dhe fëmijët të ndahen nga anëtarët tjerë të familjes.
- Të
  shfrytëzohen peceta, të dezinfektohen sipërfaqet dhe gjësendet, sa më shpesh të lahen rrobat, mbajtja e higjienës së duarve është esenciale dhe të shmanget prekja e hundës, gojës dhe
  syve.
- Gjatë
  kollitjes dhe teshtitjes të përdoret peceta dhe ato të hudhen në vende të
  sigurta.
- Nëse
  ka mundësi secili të bëjë gjumin në shtratin e vet dhe të shfrytëzojë banjo
  personale.
- Mos
  pranoni vizita nga të afërmit dhe miqtë në shtëpi.
- Nëse
  keni kafshë shtëpiake largoni ato ose pas çdo kontakti me to lani duart me ujë
  dhe sapun.
- Monitoroni
  simptomet e juaja.
- Thirrni
  mjekun tuaj para vizitës në kujdesin shëndetësor.
- Menaxhoni
  në mënyrën e duhur mbeturinat.

- Brenda mjediseve të institucioneve
  të kujdesit shëndetësor, të forcohen praktikat standarde të parandalimit të
  infeksionit dhe kontrollit në spitale, veçanërisht në shërbimet e urgjencës!
- IKSHPK rekomandon të gjithë që të
  mos udhëtojnë drejt zonave/ shteteve me Koronavirus, nëse nuk e kanë të
  domosdoshme!

Në nivel global, nga data 31 dhjetor 2019
deri më 12 mars 2020 sipas ECDC, janë raportuar gjithsej 125.518 raste të COVID-19
me 4.617 raste të vdekjes, përderisa në BE/AEE dhe Mbretëri të bashkuar janë
raportuar gjithsej 22.105 raste të COVID-19 me 943 raste të vdekjes: Itali (827),
Francë (48), Spanjë (47), Mbretëri të Bashkuar (6), Holandë (5), Belgjikë (3),
Gjermani (2), Greqi (1), Irlandë (1) dhe Suedi (1) .

Në rast të ndryshimit apo përkeqësimit të
situatës epidemiologjike me COVID-19 në Kosovë, rekomandimet mund të pësojnë
ndryshime. Qytetarët do të jenë të informuar në kohë reale për çdo ndryshim
eventual të tillë.

INFORMATA RRETH COVID-19



Uleni rrezikun e infektimit me Koronavirus !

KUSH ËSHTË KONTAKT I AFËRT (I NGUSHTË) I NJË RASTI TË DYSHIMTË OSE TË VËRTETUAR ME COVID-19?

PËR MË TEPËR JU LUTEM SHKARKONI DOKUMENTIN NË VEGZËN VIJUESE:

http://niph-rks.org/wp-content/uploads/2020/03/kush_eshte_kontakti.pdf?fbclid=IwAR09osvUasPBMl1Dafw5uuWw5wXdILkvpk2Igzt9D4DKY2Kkk6DvHMmHvI4

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravsta / Ministry of Health
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute Public Health of Kosova

Novel Coronavirus (COVID-19)

A keni qëndruar në një shtet ku është i përhapur koronavirusi i ri COVID-19?

Nëse **PO**, kontrolloni gjendjen tuaj shëndetësore gjatë 14 ditëve në vijim pas kthimit nga udhëtimi

Shenjat dhe simptomat kryesore për koronaviruisn e ri COVID-19 janë:

- Temperaturë mbi 38ºC (100.40ºF), ethe, kollitje të thatë, vështërsi në frymëmarrje, dhembje të muskujve.
- Disa persona mund të kenë shenja dhe simptoma të dukshme të traktit të sipërm respirator (rrjedhje hunde, teshtitje ose dhimbje të fytit).

Nëse shfaqen shenja dhe simptoma në 10 ditët e ardhshme gjatë qëndrimit në një vend apo pas kthimit në vend me koronavirusin e ri COVID-19:

- Gjatë fluturimit: Informoni menjëherë ekuipazhin e aeroplanit;
- Në Kosovë: Mjekun tuaj ose Klinikën Infektive (SHSKUK) duke i treguar historikun e udhëtimit tuaj

Evitoni të gjitha kontaktet e afërta me personat tjerë

Për informata shtesë konsultoni:

Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike: www.niph-rks.org
Organizatën Botërore të Shëndetësisë: www.who.int
Qendra Europiane për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes: www.ecdc.europa.eu



INFORMATA RRETH VIRUSIT COVID-19
TELEFONONI NË: 038 200 80 800

PARANDALIMI I PËRHAPJES SË COVID-19 NË SHTËPI DHE KOMUNITETE

Udhëzimet e mëposhtme ndihmojnë në parandalimin e përhapjes së Covid-19 mes njerëzve në shtëpi dhe në bashkësi. Udhëzimi i përkohshëm bazohet në ato që dimë aktualisht në lidhje me infeksionet e tjera virale të frymëmarrjes dhe Covid-19. CDC (Center for Control Disease-Qendra për Kontrollë të

Sëmundjeve) do të përditësojë këtë udhëzim të përkohshëm sipas nevojës.

PËR MË TEPËR JU LUTEM SHKARKONI DOKUMENTIN NË VEGZËN VIJUESE:

http://niph-rks.org/wp-content/uploads/2020/03/Parandalimi-i-Covid-ne-kushte-shtepiake.pdf?fbclid=IwAR2jEL6GA9jEKV8OypQrWjdRRouJfPTudZlA9ZDrUdO2wMHjn6Am5P-05zA



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravsta / Ministry of Health
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute Public Health of Kosova

Thirrje publike!
Koronavirusi: COVID-19

Ne jemi të përgatitur të përballemi me sëmundjen COVID-19
Por, na duhet ndihma juaj gjithashtu!

- **Nëse vini nga vendet e prekura me sëmundjen COVID-19**
- **Nëse keni pasur kontakt me person të dyshuar ose të prekur me COVID-19**
- **Nëse keni simptoma si ethe, temperaturë, kollë**
- **Ju lusim të qëndroni në shtëpi dhe të shmangni kontaktet!**
- **Për më shumë informata rreth koronavirusit dhe si të veproni më tej, thirrni në numrin me pagesë (0.02 EUR/min):**

038 200 80 800

Ju mund të mbroni veten dhe të tjerët që të mos sëmureni:

- **Lani duart mirë dhe sa më shpesh me ujë dhe sapun 20-30 sekonda ose pastroni me dezinfektues me bazë alkooli!**
- **Kur kolliteni apo teshtini, mbulojeni gojën apo hundën me gropëzën e brrylit apo me faculetë (pastaj faculetën hidheni menjëherë në mbeturina)!**
- **Mbani distancë 1-2 metër nga njëri tjetri!**
- **Mos u përshëndetni me shtrëngim duarsh duar dhe përqafime!**
- **Qëndroni në shtëpi nëse keni simptoma të lehta të sëmundjes!**
- **Pushoni në shtëpi, mos shkoni në punë ose në shkollë, në mënyrë që të mos e përhapni virusin tek të tjerët!**
- **Shmangni pjesëmarrjen në ngjarjet publike dhe jopublike me grumbullim të njerëzve në ambiente të hapura ose të mbyllura!**
- **Shmangni kontaktet e afërta me çdo person të familjes ose shoqërisë!**
- **Konsumoni sa më shumë lëngje, pemë dhe perime!**
- **Pastroni ambientet e shtëpisë me dezinfektues me bazë klori apo alkooli!**

RUAJE SHËNDETIN GJATË UDHËTIMIT
OSTANITE ZDRAVI TOKOM PUTOVANJA
STAY HEALTHY WHILE TRAVELLING

Shmangni udhëtimin nëse keni ethe / temperaturë dhe kollitje

Izbegavajte putovanje ako imate povišenu temperaturu i kašalj

Avoid travel if you have a fever and cough



Shmangni kontaktin e ngushtë me njerëzit që kanë simptoma, si ethe/temperaturë dhe kollitje

Izbegavajte blizak kontakt sa osobama koje imaju povišenu temperaturu i kašalj

Avoid close contact with people suffering from a fewer and cough





Lani duart shpesh me sapun dhe ujë apo pastroni me dezinfektues për duar me bazë alkooli

Često čistite ruke sredstvom na bazi alkohola ili sapunom i vodom

Frequently clean hands by using alcohol-based hand rub or soap and water



Nëse keni ethe / temperaturë, kollitje dhe vështirësi në frymëmarrje kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore dhe ndajeni historikun e udhëtimeve me profesionistët shëndetësor

Ako imate povišenu temperaturu, kašalj i otežano disanje potražite što pre lekarsku pomoć i svom lekaru kažite prethodnu istoriju putovanja

If you have a fever, cough and difficulty breathing seek medical care early and share previous travel history with your health care provider

Shmangni prekjen e syve, hundës apo gojës

Izbegavajte da dodirujete oči, nos ili usta

Avoid touching eyes, nose or mouth



Kur kolliteni dhe teshtini mbuloni gojën dhe hundën me parakrah apo me faculetë - hudheni mënjëherë faculetën pas përdorimit, lani duart

Kada kašljete i kijate pokrijete usta i nos sa savijenim laktom ili maramicom - maramicu odmah bacite i operite ruke

When coughing and sneezing cover mouth and nose with flexed elbow or tissue – throw tissue away immediately and wash hands



Nëse sëmureni gjatë udhëtimit, informojeni ekuipazhin dhe kërkoni ndihmë mjekësore menjëherë

Ukoliko se razbolite tokom putovanja, obavestite posadu / osoblje i odmah zatražite lekarsku pomoć

If you become sick while travelling, inform crew and seek medical care early





Nëse kërkoni ndihmë mjekësore, ndajeni historikun e udhëtimeve me profesionistët shëndetësor

Ako vam je potrebna lekarska pomoć, kažite svom lekaru istoriju putovanja

If you seek medical attention, share travel history with your health care provider

Nëse vendosni të përdorni maskë për fytyrë, sigurohuni që të mbuloni gojën dhe hundën - shmangni prekjen e maskës pasi ta keni vendosur atë

Ako odlučite da nosite masku za lice, obavezno prekrijte usta i nos - izbegavajte da dodirujete masku kada je nosite

If you choose to wear a face mask, be sure to cover mouth and nose – avoid touching mask once it's on



Pas shfrytëzimit të maskës për një përdorim të vetëm, hidheni atë menjëherë dhe lani duart pas hjekjes së saj

Odmah bacite masku za jednokratnu upotrebu nakon svake upotrebe i operite ruke nakon skidanja maski

Immediately discard single-use mask after each use and wash hands after removing masks

Hani vetëm ushqime të gatuara mirë

Jedite samo dobro skuvanu hranu

Eat only well-cooked food





Shmangni të pështyni në vend publik

Izbegavajte da pljujete u javnosti

Avoid spitting in public

Shmangni kontaktin e afërt dhe udhëtimin me kafshët e sëmura

Izbegavajte bliski kontakt i putovanje sa životinjama koje su bolesne

Avoid close contact and travel with animals that are sick



World Health Organization

Zbatoni sigurinë ushqimore
Bezbedno pripremanje hrane
Practise food safety

Përdorni dërrasa për prerje dhe thika të ndryshme për mish të papërpunuar dhe ushqime të gatuara

Koristite različite daske i noževe za sirovo meso i kuvanu hranu

Use different chopping boards and knives for raw meat and cooked foods





Pastroni/lani duart midis trajtimit të ushqimit të papërpunuar dhe atij të gatuar

Operite ruke između rukovanja sa sirovom i kuvanom hranom

Wash your hands between handling raw and cooked food

Kafshët e sëmura dhe kafshët e ngrodhura nga sëmundja nuk duhet ngrënë

Bolesne životinje i životinje koje su uginule od bolesti ne smeju da se jedu

Sick animals and animals that have died of diseases should not be eaten





Edhe në zonat ku ka shpërthim të epidemisë, produktet e mishit mund të konsumohen në mënyrë të sigurt nëse këto produkte gatuhen tërësisht dhe trajtohen siç duhet gjatë përgatitjes

Čak i u područjima gde je došlo do izbijanja epidemije, mesni proizvodi se mogu bez problema konzumirati ako su te namirnice dobro skuvane i ako se sa njima tokom pripreme hrane postupa na odgovarajući način

Even in areas experiencing outbreaks, meat products can be safely consumed if these items are cooked thoroughly and properly handled during food preparation

World Health Organization

Mbroni veten dhe të tjerët që të mos sëmureni / Zaštitite sebe i druge da se ne razbolite / Protect yourself and others from getting sick

Lani duart / Perite svoje ruke / Wash your hands



- pas kollitjes apo teshtitjes
- gjatë kujdesit për të sëmurët
- para, gjatë dhe pas përgatitjes së ushqimit
- para ngrënies
- pas përdorimit të toaletit
- kur duart janë dukshëm të papastra
- pas trajtimit të kafshëve apo mbetjeve të tyre
- posle kašljanja ili kijanja
- prilikom nege bolesnika
- pre, za vreme i posle pripreme hrane
- pre jela
- nakon upotrebe toaleta
- kada su ruke vidljivo prljave
- nakon kontakta sa životinjama ili životinjskim izmetom
- after coughing or sneezing
- when caring for the sick
- before, during and after you prepare food
- before eating
- after toilet use
- when hands are visibly dirty
- after handling animals or animal waste

Pastroni/lani duart me sapun dhe ujë të rrjedhshëm kur duart janë dukshëm të ndotura

Perite svoje ruke sapunom i tekućom vodom kada su ruke vidljivo prljave

Wash your hands with soap and running water when hands are visibly dirty





Nëse duart nuk i keni shumë të ndotura, atëherë lani shpesh ato me sapun dhe ujë apo me dezinfektues për duar me bazë alkooli

Ako vam ruke nisu vidljivo prljave, često ih čistite sredstvom na bazi alkohola ili sapunom i vodom

If your hands are not visibly dirty, frequently clean them by using alcohol-based hand rub or soap and water

Mbroni të tjerët që të mos sëmuren / Zaštitite sebe i druge da se ne razbolite / Protect others from getting sick

Mbuloni hundën dhe gojën me faculetë apo me mëngë të parakrahut kur kolliteni ose teshtini

Prilikom kašljanja i kijanja pokrijte usta i nos savijenim laktom ili maramicom

When coughing and sneezing cover mouth and nose with flexed elbow or tissue





Shmangni kontaktin e ngushtë kur ju keni kollë dhe ethe / temperaturë

Izbegavajte bliski kontakt kada imate kašalj i povišenu temperaturu

Avoid close contact when you are experiencing cough and fever



Pas përdorimit, hudhni menjëherë faculetat në shportën e mbyllur

Bacite maramicu u zatvorenu kantu odmah nakon upotrebe

Throw tissue into closed bin immediately after use

Mos pështyni në vend publik

Izbegavajte da pljujete u javnosti

Avoid spitting in public



Lani duart me dezinfektues me bazë alkool apo sapun dhe ujë pas kollitjes apo teshtitjes dhe gjatë kujdesit për të sëmurin

Očistite ruke sredstvom na bazi alkohola ili sapunom i vodom nakon kašljanja ili kijanja ili kada negujete bolesnu osobu

Clean hands with alcohol-based hand rub or soap and water after coughing or sneezing and when caring for the sick





Nëse keni ethe / temperaturë, kollitje dhe vështirësi në frymëmarrje kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore dhe ndajeni historikun e udhëtimeve me profesionistët shëndetësor


Ako imate povišenu temperaturu, kašalj i otežano disanje, potražite što pre lekarsku pomoć, a svoju prethodnu istoriju putovanja kažite svom lekaru.

If you have fever, cough and difficulty breathing seek medical care early and share previous travel history with your health care provider


World Health Organization



Informata për koronavirusin



Çfarë është koronavirusi?



Koronavirusi i takon familjes së viruseve të cilët shkaktojnë sëmundje duke filluar nga një rrufë e lehtë deri në sëmundje më të rënda siç është Sindroma Respiratore e Lindjes së Mesme (**MERS**) dhe Sindroma e Rëndë Respiratore Akute (**SARS**).

Nga vjen koronavirusi?

Koronavirusi qarkullon në kafshë, dhe në disa raste bartet nga kafshët te njeriu. Tashmë është vërtetuar që koronavirusi bartet edhe nga njeriu te njeriu.



Koronavirusi përhapet përmes:

- Ajrit, kollës dhe tështitjes
- Kontaktit të afërt personal, si prekja, përqafimi, dhënia e dorës
- Përmes kontaktit me sipërfaqe dhe gjësende të kontaminuara

Cilat janë simptomat e një personi të infektuar me koronavirus?

Simptomet e zakonshme janë:

- temperaturë
- ethe
- kollë
- gulçim
- vështirësi në frymëmarrje



Në rastet më të rënda, infeksioni mund të shkaktojë pneumoni, sindromë të rëndë respiratore akute.

Ruaje shëndetin gjatë udhëtimit

- Shmangeni udhëtimit nëse keni ethe, temperaturë dhe kollitje
- Nëse sëmureni gjatë udhëtimit, informojeni ekuipazhin dhe kërkoni ndihmë mjekësore menjëherë!



Si të mbohemi nga koronavirusi?



- Larja e shpeshtë e duarve me ujë dhe sapun për 20-30 sekonda, ose me dezinfektues me përmbajtje alkooli, e sidomos pas teshtitjes dhe kollitjes
- Mbulimi i gojës dhe hundës me faculetë, me mëngë ose parakrah gjatë kollitjes dhe teshtitjes
- Faculetat e përdorura hudhni në shportën më të afërt të mbeturinave
- Shmangia e kontakteve të ngushta me çdo person që shfaq shenja të sëmundjeve respiratore
- Shmangia e qëndrimit në ambiente të mbyllura dhe të mbingarkuara
- Shmangia e kontakteve të panevojshme me kafshë të gjalla apo produket e tyre, larja e duarve pas kontaktit me to



- Aplikimi i praktikave të sigurta për përgatitjen e ushqimit
- Pastrimi i ambinetit me dezinfektues me bazë klori ose alkooli
- Nëse keni ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore dhe tregoni historikun eventual të udhëtimit jashtë vendit
- Personat e sëmurë duhet të qëndrojnë në shtëpi në mënyrë që të parandalohet përhapja e sëmundjes

Nuk ka vaksinë për këtë lloj të ri të koronavirusit

Kur një sëmundje është e re, nuk ka vaksinë për të dhe kërkohet kohë derisa të prodhohet vaksina. Megjithatë, shumë nga shenjat mund të mjekohen në varësi të gjendjes klinike të pacientit.

Vizitoni mjekun tuaj për këshilla dhe mjekim nëse nuk e ndjeni veten mirë!




Komunikatë për media


NJOHURITË BAZIKE DHE MASAT MBROJTËSE PËR CORONAVIRUS COVID-19


kush_eshte_kontaktiDownload

Parandalimi i Covid ne kushte shtepiakeDownload









Nasheni kotar qalavipe e maskako kana vastinena ola



#CORONAVIRUS #COVID19
RESURSI: WORLD HEALTH ORGANIZATION (WHO)

Yaverineni e maska e neva te sine kay sitoy sapandi thay ma vastineni palem e maska vash yekhverutno vastipe



#CORONAVIRUS #COVID19
RESURSI: WORLD HEALTH ORGANIZATION (WHO)

Vash te ciden e maska: cideni ola palal (ma qalaveni angluno kotor e maskako); frdeni yekhatar ani phandi kanta; shuzhareni tumare vasta




#CORONAVIRUS #COVID19
RESURSI: WORLD HEALTH ORGANIZATION (WHO)





YOUTH OF KOSOVO
7 NAPYA VASH ANGLOAQHAVIPE E BAYRIPESKO E COVID-19



01.
Besheni khere
#CORONAVIRUS #COVID19
RESURSI: WORLD HEALTH ORGANIZATION (WHO)



02.
Thoveni tumare vasta buti ver
#CORONAVIRUS #COVID19
RESURSI: WORLD HEALTH ORGANIZATION (WHO)


03.
Nasheni kotar qalavipe tumare yakhengo, nakesko thay mosko
#CORONAVIRUS #COVID19
RESURSI: WORLD HEALTH ORGANIZATION (WHO)









Komunikatë për media

Prishtinë, 11 mars 2020

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës njofton opinionin se gjatë ditës së sotme në Laboratorin e

Mikrobiologjisë molekulare
janë testuar 7 mostra të dyshimta për Koronavirus .

Pas
analizave të kryera, të 7 (shtatë) rastet e testuara kanë rezultuar
negative.

Sikurse edhe ditëvë të kaluara, MSh dhe IKSHPK do ta
njoftojnë në kohë reale publikun për rastet e testuara për Koronavirus dhe
rezultatet e tyre.

Demant lidhur me lajmin për rastin e dyshuar për Koronavirus

Prishtinë, 11 mars 2020

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës njofton opinionin se gjatë ditës së sotme në Laboratorin e Mikrobiologjisë molekulare
janë duke u testuar 7 mostra dhe në orët e mbrëmjes do të dalin rezultatet.

Deri

tash nuk ka asnjë rast të konfirmuar me virusin COVID-19.

Prandaj, duke qenë që për këto raste nuk ka ende rezultate, lusim mediat dhe publikun që të jenë të durueshëm dhe të marrin informacione
nga burimet zyrtare që janë MSh dhe IKSHPK.

Sikurse edhe ditëvë të kaluara, publiku në Kosovë do të njoftohet në baza ditore për rastet e testuara për Koronavirus dhe rezultatet e
tyre.